



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë __. __. 2025

**PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË
INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 12 pika 3, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm, si institucion publik, qendror, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.
2. Inspektorati i Përgjithshëm financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Misioni i Inspektoratit të Përgjithshëm është përmirësimi dhe rritja e nivelit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë gjatë kryerjes së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

1. Inspektorati i Përgjithshëm kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e ligjit për inspektimin.
2. Inspektorati i Përgjithshëm ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Harton dhe miraton rregullat dhe metodologjinë për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raporton për veprimtarinë e inspektorateve qendrore dhe vendore;
 - b) krijon dhe mban një bazë të dhënash të qendëruar, me profile individuale të subjekteve të inspektimit sipas fushës së veprimtarisë së tyre, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të inspektimeve;
 - c) koordinon dhe monitoron veprimtaritë e inspektimit të inspektorateve qendrore dhe vendore;
 - ç) monitoron zbatimin e politikave dhe standardeve të inspektimit, të miratuara nga bordi i

- inspektimeve dhe të treguesve të performancës në fushën e inspektimit, si dhe raporton përpara bordit për çështjet që janë në funksion të këtij të fundit, çdo 6 muaj, brenda datave 20 korrik dhe 20 janar të vitit kalendarik;
- d) jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit brenda 10 ditëve nga administrimi i projektaktit ligjor apo nënligjor;
- dh) kryen trajnimin dhe kualifikimin e inspektorëve qendrorë dhe vendorë, në bashkërendim me inspektoratet qendrore dhe vendore;
- e) mban dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të inspektorëve qendrorë dhe vendorë, bazuar në listat dhe informacionin e përgjithshëm të inspektorëve në detyrë, të dërguara nga inspektoratet qendrore dhe vendore;
- ë) trajton të gjitha informacionet nga të tretët, ankesat, denoncimet e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë për veprimtaritë e inspektorëve dhe inspektorëve, si dhe procedurat e inspektimit, përfshirë edhe ankesat që kryhen në platformën ndërqeveritare të ndërveprimit, sipas afatëve dhe procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative;
- f) miraton çdo kërkesë nga inspektoratet qendrore dhe vendore, që lidhet me zbatimin e procedurës inspektuese, ndryshimin apo veprimet në sistemin elektronik unik “e-Inspektimi”, që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tyre inspektuese;
- g) lëshon kartën e përkohshme të identifikimit të inspektorit në kohë prove, si dhe kartën e inspektorit në detyrë për inspektoratet qendrore, ndërsa për inspektorët vendorë gjeneron numrin e identifikimit të kartës së inspektorit;
- gj) mban dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të inspektorëve qendrorë dhe vendorë, bazuar në listat dhe informacionin e përgjithshëm të inspektorëve në detyrë, të administruara nga inspektoratet qendrore dhe vendore;
- h) përcakton rregullat për realizimin e veprimtarisë inspektuese në raste të jashtëzakonshme, kur nuk është i mundur ushtrimi i veprimtarisë inspektuese në distancë (online) nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimeve “e-Inspektimi” Inspektorati i Përgjithshëm ka këto detyra dhe përgjegjësi për inspektoratet qendrore:
- i) jep mendim këshillimor për programet vjetore dhe miraton programet mujore të inspektimit, të hartuara nga inspektoratet qendrore, brenda 5 ditëve pune nga administrimi i tyre;
- j) bashkërendon, koordinon dhe mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorëve qendrore;
- k) mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët qendrorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit;
- l) jep mendim për programet buxhetore afatmesme dhe afatgjata, të hartuara nga inspektoratet qendrore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes;
- ll) vlerëson kapacitetet dhe situatën infrastrukturore ekzistuese për realizimin e procedurës së inspektimit dhe bën rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre, në kuadër të parashikimeve të nevojshme të buxheteve afatmesme dhe afatgjata për inspektoratet qendrore.
3. Inspektorati i Përgjithshëm ka këto detyra dhe përgjegjësi për inspektoratet vendore:
- a) koordinon dhe mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorëve vendore, me qëllim shmangien e mbivendosjes së kompetencave në fushën e inspektimeve me inspektoratet qendrore;

- b) mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët vendorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit;
 - c) mbikëqyr procedurat e rekrutimit dhe shkarkimit të inspektorëve vendorë nga detyra, me qëllim garantimin e standardeve profesionale në fushën e inspektimit;
 - ç) mbikëqyr procedurat e ankimimit të dënimit administrativ, si dhe merr pjesë në komisionin e shqyrtimit të ankimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në ligjin për inspektimin.
4. Inspektorati i Përgjithshëm fillon menjëherë procedurën për ngritjen e komisionit disiplinor, kur konstaton shkelje disiplinore, gjatë ushtrimit të detyrës për inspektorët e të gjitha pozicioneve të punës në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe inspektoratet qendrore.
5. Inspektorati i Përgjithshëm promovon rëndësinë e zbatimit të legjislacionit nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuëse, botimeve, publikimeve, konferencave, seminareve, forumeve apo konsultimeve me grupet e interesit.
6. Inspektorati i Përgjithshëm përgatit e publikon raporte për veprimtarinë inspektuese të inspektorateve qendrore dhe vendore.
7. Në lidhje me informacionin dhe bazën e të dhënave të inspektimit, Inspektorati i Përgjithshëm:
- a) menaxhon bazën qendrore e të integruar të të dhënave, sipas fushave të inspektimit që mbulon, kryen analiza të ndryshme, si dhe shpërndan informacionin, duke zbatuar standardet e cilësisë dhe të konfidencialitetit;
 - b) përditëson sistemin e integruar të informacionit të inspektimit në fushat respektive, duke garantuar aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave sipas ligjit (portali “e-albania”, QKB, Doganat, HRMIS, Bashkëqeverisja, EDRMS, Sistemi i nënshkrimit elektronik, Tatimet, etj.);
 - c) drejton dhe bashkërendon punën për gjenerimin, grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave, cilësore e sasiore, për burimet e sektorëve të inspektimit që mbulon.
8. Inspektorati i Përgjithshëm kryen vlerësime, si dhe propozon metoda e teknika inovative, që kontribuojnë në rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në fushat e inspektimit, si dhe bashkëpunon me institucione përkatëse e analoge, vendase dhe të huaja, që punojnë në fushat e inspektimit që mbulon.
9. Për realizimin e funksioneve të tij, Inspektorati i Përgjithshëm, ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e inspektorateve qendrore dhe vendore, të kontrollojë dhe inspektojë dosjet e inspektimit, si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me programimin e kryerjen e procedimeve administrative të inspektimit, si dhe ka të drejtë të mbikëqyrë në terren procedurën e inspektimit të inspektorateve qendrore dhe vendore.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

- 1. Veprimtaria e Inspektoratit të Përgjithshëm drejtohet nga inspektori i Përgjithshëm, i cili e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.
- 2. Inspektori i Përgjithshëm mbështetet nga zëvendësinspektori i Përgjithshëm.
- 3. Struktura dhe organika e Inspektoratit të Përgjithshëm miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- 4. Marrëdhëniet e punësimit për inspektorët e Inspektoratit të Përgjithshëm rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, dispozitave të ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe

akteve nënligjore, në zbatim të tij. Marrëdhëniet e punësimit për punonjësit, që ushtrojnë funksione publike dhe për punonjësit administrativë që nuk ushtrojnë një funksion publik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

5. Inspektori i Përgjithshëm ka këto detyra:

- a) mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarive inspektuese të inspektorateve qendrore, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë;
- b) bashkërendon drejtimit strategjike dhe objektivat e inspektorateve qendrore dhe vendore;
- c) nxjerr urdhra dhe rregullore në zbatim të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) miraton formën dhe përmbajtjen e dokumenteve standarde të procedurave të inspektimit, me propozim të inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave të tjera inspektuese;
- d) miraton raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve për inspektoratet qendrore dhe vendore dhe e paraqet pranë Këshillit të Ministrave dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda datës 20 mars të vitit pasardhës, për njohje Këshillit të Ministrave.
- dh) miraton formatin e raportit vjetor të veprimtarive të inspektorateve që i paraqitet bordit të inspektimeve, formatin e raportit të veprimtarisë inspektuese të inspektorateve qendrore dhe vendore, si dhe formatin e raportit të përgjithshëm vjetor të inspektimeve.
- dh) miraton çdo kërkesë të administruar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm nga inspektoratet qendrore dhe vendore, që lidhet me zbatimin, ndryshimin apo veprimet në sistemin unik “e-Inspektimi”;
- e) bashkëvepron me institucionet shtetërore sipas parashikimeve në piken 8 shkronja b, kreu II, të këtij vendimi, të cilat administrojnë sisteme elektronike me të dhënat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive inspektuese, të cilat do të ndërveprojnë me sistemin unik “e-Inspektimi”.

6. Inspektori i Përgjithshëm urdhëron me shkrim dhe në formë të arsytuar të inspektorateve qendrore, për fillimin e një inspektimi në koordinim me inspektoratet vendore, për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete. Urdhri për fillimin e procedurës së inspektimit sipas kësaj pike duhet të jetë në formë të shkruar, i motivuar dhe të përmbajë të dhëna të qarta për objektin dhe subjektin e inspektimit, bazën ligjore, si dhe qëllimin dhe kohëzgjatjen e inspektimit.

IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE

1. Inspektorati i Përgjithshëm identifikohet me stemën dhe vulën e tij zyrtare.

2. Stema e Inspektoratit të Përgjithshëm përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Inspektorati i Përgjithshëm”.

3. Vula e Inspektoratit të Përgjithshëm ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare” dhe shënimin identifikues “Inspektorati i Përgjithshëm”.

4. Logo e Inspektoratit të Përgjithshëm përdoret dhe mbahet vetëm nga Inspektorati i Përgjithshëm, si mjet identifikues institucional, si dhe në kartën e inspektorit.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

- 1.Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Inspektorati Qendror rristrukturohet në Inspektoratin e Përgjithshëm.
- 2.Nëpunësit dhe punonjësit administrativë të Inspektoratit Qendror transferohen pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me strukturën organizative të miratuar.
- 3.Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Qendror, të cilët kryejnë funksionet e mbikëqyrjes së inspektimeve dhe koordinimit, trajtohen sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Qendror, të cilët kryejnë funksionet horizontale, në kuptim të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, trajtohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe rristrukturimit të institucionit.
5. Punonjësit aktualë të Inspektoratit Qendror, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, transferohen pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me strukturën organizative të miratuar.
- 6.Procedurat për riorganizimin dhe rristrukturimin e Inspektoratit Qendror në Inspektoratin e Përgjithshëm përfundojnë brenda një afati jo më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 7.Vendimi nr. 630, datë 14.09.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror” shfuqizohet.
- 8.Ngarkohet Inspektorati i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama